

# EU POLICY BRIEFS MACEDONIA



Konrad  
Adenauer  
Stiftung



## Gjendja me (pa) sigurinë energjetike në Maqedoni

Tetor 2014

[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)

[www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)

Siguria energjetike ka një rëndësi të jashtëzakonshme për sigurinë. Ky dokument e analizon gjendjen rreth sigurisë energjetike në Maqedoni dhe i identifikon çështjet kryesore të cilat e rëndojnë situatën e përmirësuar energjetike.

**ANDREJA BOGDANOVSKI &  
ANA STOJLOVSKA**  
Analitika Think Tank, Maqedoni



## Hyrje

Siguria energjetike edhe më tutje është njëra nga çështjet më të diskutuara të sigurisë në BE dhe veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Maqedonia, si një vend i vogël pa dalje në det, pa resurse të veta të gazit natyror dhe naftës, vend kandidat për anëtarësim në BE dhe NATO, përpiqet në mënyrë strategjike ta planifikojë dhe përmirësojë sigurinë e vet energjetike. Edhe pse janë miratuar më shumë dokumentet relevante, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë energjetike, faktet si pamundësia për ballafaqimin me kërkesën e madhe të energjisë elektrike si në muajin shkurt të vitit 2012<sup>1</sup>, rritja vjetore e varësisë<sup>2</sup> energjetike dhe furnizimi me gaz natyror nga një burim e japin pasqyrën e një gjendjeje problematike të sigurisë energjetike. Përveç kësaj, një studim i Këshillit Energjetik Botëror në temën e qëndrueshmërisë, Maqedoninë e klasifikon në vendin e 89, sa i përket sigurisë energjetike nga 129 vende për vitin 2013; me ç'rast nga vendet e rajonit më keq të klasifikuara nga Maqedonia në vitin 2013 ishte Serbia (101) dhe Mali i Zi (115), ndërkaq më mirë të klasifikuara ishin Shqipëria (87), Kroacia (66), Sllovenia (60), Greqia (54), Bullgaria (26), dhe Rumania (9).<sup>3</sup>

Meqë siguria energjetike ka një rëndësie esenciale për sigurinë kombëtare, duhet të analizohet më në hollësi gjendja e saj në Maqedoni dhe të identifikohen problemet kryesore të cilat pamundësojnë një siguri më të mirë energjetike. Prandaj, ky punim nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjetikës (IEA) ndërmerr katër dimensionet e sigurisë energjetike afatshkurtra (edhe pse

<sup>1</sup> Në muajin shkurt të vitit 2012 Maqedonia u ballafaqua me mungesë të energjisë elektrike për përmbushjen e kërkesës së saj. Masa e ndërmarrë preliminare ishte reduktimi i ndriçimit rrugor. Burimi: MIA/Idividi, "Qeveria shpalli gjendjen e krizës energjetike", 13 shkurt 2012, vizituar më 23 tetor, 2014 <http://www.idividi.com.mk/vesti/makedonija/748029/>

<sup>2</sup> Varësia energjetike e Maqedonisë në vitin 2012 është thuhja se 50% dhe e njëjta është rritur gjatë disa viteve të fundit, siç theksohet në Entin Shtetëror të Statistikës. Burime: Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilancet energjetike 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2013/6.1.13.87.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës "Bilancet energjetike 2011", (2012), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/6.1.12.82.pdf>

<sup>3</sup> Mes tjerash, i klasifikon të arriturat në energjetikë përmes kategorizimit të sigurisë energjetike për vitet 2011, 2012 dhe 2013. Këtu, siguria energjetike përkufizohet si menaxhim efektiv me furnizimin me energji primare nga burime vendase dhe të jashtme, siguri të infrastrukturës energjetike dhe aftësi për kompanitë energjetike të tregut ta përmbushin kërkesën e tanishme dhe të ardhshme. Burimi: Këshilli Botëror i Energjetikës/ Indeksi i qëndrueshmërisë për Maqedoninë. Vizituar më 23 tetor 2014

të njëjtat janë pak të modifikuara në këtë punim që t'i përshtaten situatës në Maqedoni):

*Rreziqet e jashtme* – rreziqe në lidhje me ndërprerjen e importit të energjisë;

*Rezistenca e jashtme* – aftësia për t'iu përgjigjur ndërprerjes së importit të energjisë përmes zëvendësimit me furnizues të tjerë dhe ruta të furnizimit;

*Rreziqe vendase* – rreziqe të cilat rezultojnë në relacionin me prodhimin vendas dhe transformimin e energjisë;

*Rezistenca vendase* – aftësia vendase që t'i përgjigjet ndërprerjes së furnizimit me energji si rezerva karburanti.<sup>4</sup>

Megjithatë, këto aspekte janë kombinuar me çështjet e sigurisë energjetike afatgjate, ndërsa janë marrë parasysh edhe përkufizimet maqedonase për sigurinë energjetike në legjislacionin përkatës. Metodologjia e përfshin analizën e strategjive relevante dhe akteve normative, të dhënave statistikore, artikuj në shtypin ditor, si dhe ndryshimet më të fundit gjeopolitike në lidhje me sigurinë energjetike.

## 1. Përkufizimi i sigurisë energjetike

Agjencia Ndërkombëtare e Energjetikes nocionin *siguri energjetike* e përkufizon si *akses i papenguar i burimeve energjetike me çmim të arsyeshëm*. Ekziston siguri energjetike afatgjate e cila para së gjithash ka të bëjë me investimet me kohë në furnizimin me energji, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe nevojat ekologjike; dhe siguri energjetike afatshkurtër e cila fokusohet mbi aftësinë e sistemit energjetik që të reagojë shpejtë ndaj ndryshimeve të papritura në balancin e ofertës dhe konsumit.<sup>5</sup> Siguria energjetike në mënyrë grafike pasqyrohet në Foto 1.


<http://www.worldenergy.org/data/sustainability-index/country/macedonia/2013/>

<sup>4</sup> IEA, IEA Model të sigurisë afatshkurtër energjetik (MOSES), (2011), vizituar më 23 tetor 2014

[http://www.iea.org/publications/freepublications/publication/moses\\_paper.pdf](http://www.iea.org/publications/freepublications/publication/moses_paper.pdf)

<sup>5</sup> IEA, Siguria në furnizimin me energji, (2014), vizituar më 23 tetor 2014

[http://www.iea.org/publications/freepublications/publication/ENE\\_RGSUPPLYSECURITY2014.pdf](http://www.iea.org/publications/freepublications/publication/ENE_RGSUPPLYSECURITY2014.pdf)



**Foto 1: Siguria energjetike e përkufizuar nga IEA**

Burimi: IEA, siguri gjatë furnizimit me energji, (2014), vizituar më 3 tetor 2014

<http://www.iea.org/publications/freepublications/publication/ENERGYSUPPLYSECURITY2014.pdf>

Korniza kryesore ligjvënëse në Maqedoni në fushën e energjetikës, Ligji për energjetikë, i jep rëndësi të madhe sigurisë energjetike me që njëri nga qëllimet e tij është të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji. Ligji e përkufizon sigurinë si *siguri gjatë furnizimit dhe sigurimit të energjisë ose burimeve energjetike dhe siguri teknike të sistemeve energjetike*. Në vazhdim, Ligji për energjetikë sqaron se siguri në furnizimin me energji ose burime energjetike sigurohet përmes: balancimit të ofertës dhe kërkesës, parashikimit të kërkesës së ardhshme, ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike, mirëmbajtjes së rrjeteve të shpërndarjes dhe të transmetimit, masave në rast të mbingarkimit dhe në rastin e pamundësisë të livrimit të energjisë.<sup>6</sup>

Në nivel strategjik, në strategjitë relevante energjetike maqedonase, siguria energjetike gjithashtu luan një rol të rëndësishëm. Në të vërtetë Strategjia Energjetike ka për qëllim të sigurojë furnizim të sigurt dhe cilësor me energji. Strategjia Energjetike e përkufizon sigurinë energjetike si *përbushje të rregullt të kërkesës të energjisë në kushte të qëndrueshme dhe ekologjike dhe me kosto të cilat nuk e ngadalësojnë zhvillimin ekonomik dhe nuk e rrezikojnë standardin jetësor të qytetarit*.<sup>7</sup> Ajo, në mënyrë të qartë, pohon se për sigurimin e sigurisë energjetike nevojitet një shumëllojshmëri më e madhe të burimeve energjetike sipas llojeve, burimeve dhe furnizuesve si dhe pjesëmarrje aktive

në tregun energjetik rajonal dhe në komunitetin energjetik evropian. Prandaj, duhet të shfrytëzohen maksimalisht resurset vendase (burime të rinovueshme dhe thëngjilli) dhe një politikë afatgjate strategjike për lidhje me linjat kryesore të Rajonit dhe më gjerë (gazsjellës, naftësjellës dhe linjat e tensionit të lartë), si dhe ndërtimi i marrëdhënieve afariste dhe miqësore me të gjithë faktorët e rëndësishëm strategjik, siç është Bashkimi Evropian, SHBA, Rusia dhe vendet e rajonit. Energjia bërthamore po ashtu konsiderohet si mundësi për rritjen e diversifikacionit, dhe me këtë mundësohet furnizimi i sigurt me energji elektrike. Ndërtimi i kapaciteteve të reja do ta përmirësojë diversifikimin dhe me këtë edhe sigurinë gjatë furnizimit me energji elektrike. Strategjia Energjetike po ashtu thekson e vë mbi çmimin e tregut të energjisë elektrike, i cili do ta përmirësojë klimën investuese, do ta rris interesimin për përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe përfshirjen e burimeve të rinovueshme. Gjithashtu, Strategjia pohon se siguria gjatë furnizimit me gaz natyror do të sigurohet përmes lidhjes me gazsjellës të cilët do ta mundësojnë furnizimin me gaz natyror nga më shumë burime të ndryshme. Ekzistimi i depove për gaz natyror, në ndonjërin nga shtetet fqinje, gjithashtu është mënyrë e cila kontribuon në drejtim të sigurisë të furnizimit.<sup>8</sup> Dy Strategjitë e tjera energjetike, Strategjia për Burime të Rinovueshme dhe Strategjia për Efikasitet Energjetik ofrojnë më pak informacione në drejtim të sigurisë energjetike, megjithatë theksojnë se siguria në furnizimin me energji, mes tjerash, nënkupton përfshirje më të madhe të burimeve të rinovueshme në konsumin final të energjisë<sup>9</sup> dhe se masat për efikasitetin energjetik, mes tjerash, çojnë në drejtim të furnizimit të sigurt me energji.<sup>10</sup> Gjithashtu, edhe vendi ynë ka Deklaratë për sigurinë e furnizimit, që është një dokument kryesisht deskriptiv i cili thekson ligje, strategji, projekte dhe faktorë relevantë për furnizimin e sigurt me energji me fokus mbi energjinë

<sup>8</sup> Ministria e Ekonomisë të Republikës së Maqedonisë, "Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030" (2010), vizituar më 23 tetor 2014 [http://www.ea.gov.mk/images/stories/E\\_Izdania/Energetika\\_Strategjia\\_za\\_energetika\\_na\\_RM\\_do\\_2030\\_SV\\_61\\_2010\\_244131078.pdf](http://www.ea.gov.mk/images/stories/E_Izdania/Energetika_Strategjia_za_energetika_na_RM_do_2030_SV_61_2010_244131078.pdf)

<sup>9</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Ekonomisë, "Strategjia për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020", (2010), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.economy.gov.mk/dokumenti/strategji/3102.html>

<sup>10</sup> Qeveria e Republikës së Maqedonisë, "Strategjia për avancimin e efikasitetit energjetik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020", (2010), vizituar më 23 tetor 2014 [http://www.ea.gov.mk/images/stories/E\\_Izdania/Regulativa/Strategjia\\_za\\_unapreduvanje\\_na\\_EE\\_vo%20RM\\_do\\_2020\\_godina\\_SV%20143-2010%20\(1\).pdf](http://www.ea.gov.mk/images/stories/E_Izdania/Regulativa/Strategjia_za_unapreduvanje_na_EE_vo%20RM_do_2020_godina_SV%20143-2010%20(1).pdf)

<sup>6</sup> "Ligji për energjetikë" "Gazeta Zyrtare" 16/11, vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/EE982E53C03DAB4C982055F184E70F66.pdf>

<sup>7</sup> Ministria e Ekonomisë të Republikës së Maqedonisë, "Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030" (2010), vizituar më 23 tetor 2014 [http://www.ea.gov.mk/images/stories/E\\_Izdania/Energetika\\_Strategjia\\_za\\_energetika\\_na\\_RM\\_do\\_2030\\_SV\\_61\\_2010\\_244131078.pdf](http://www.ea.gov.mk/images/stories/E_Izdania/Energetika_Strategjia_za_energetika_na_RM_do_2030_SV_61_2010_244131078.pdf)



elektrike, gazin natyror dhe naftën.<sup>11</sup> Në fushën e sigurisë, dokumentet strategjike maqedonase i përkufizojnë si kërcënim kombëtar, subkombëtar dhe individual pasojat e konfliktit të interesit për shfrytëzimin e burimeve dhe rutave të materialeve strategjike energjetike, si dhe bllokimin e importit të tyre në Republikën e Maqedonisë.<sup>12</sup>

## 2. Goditjet e jashtme ndaj sigurisë energjetike

Ngjarjet e jashtme, qofshin ato të karakterit politik, ekonomik ose klimatik në Evropë dhe fqinjësinë e saj të drejtpërdrejtë kanë potencial të ndikojnë mbi furnizimin me energji në Maqedoni. Lirisht mund të themi se kriza në Ukrainë dhe çështjet klimatike janë në fokusin e diskutimeve kur bëhet fjalë për rreziqet e jashtëm, me ç'rast gazi natyror e zë vendin qendror, si në mesin e atyre që i krijojnë politikat, ashtu edhe në mesin e komunitetit hulumtues.

Pozita gjeografike e Maqedonisë në qendër të Gadishullit Ballkanik, si dhe mospasja e traseve të rëndësishme të tubacioneve të gazit nëpër territorin e saj, këtë vend e bëjnë plotësisht të varur nga importi i gazit nga Rusia. Mospasja e daljes në det në të kaluarën e dëshmoi fragjilitetin e vendit në lidhje me konsumin e naftës që e bën në mënyrë plotësisht të varur nga marrëdhëniet politike me shtetet fqinje. Kur bëhet fjalë për energjinë elektrike, ndërsa në krahasim me konsumin e gazit dhe naftës, Maqedonia tregon pavarësi më të madhe, para së gjithash, duke u mbështetur në prodhimin vendas, si dhe importin nga jashtë.

Duke e shqyrtuar të kaluarën, sigurisht se kërcënimin më i madh për sistemin energjetik maqedonas i natyrës politike mund të locohet në embargon greke, e cila pasoi pas shpalljes së pavarësisë maqedonase (shkurt 1994 - tetor 1995). Natyra politike e embargos rezultoi nga përdorimi i flamurit të vjetër maqedonas, i cili në vetvete e kishte inkorporuar Yllin e Kutleshit, i cili nga ana e personave zyrtarë grek konsiderohej se implikon provokime territoriale dhe historike.

Embargoja e gjatë prej 18 muajsh, mes tjerash, e përfshinte edhe ndalimin e plotë të naftës dhe burimeve të tjera energjetike të cilat vinin nga porti grek i Selanikut. Kjo, i

shkaktoi dëme serioze industrisë maqedonase e cila edhe ashtu ishte mjaft e brishtë<sup>13</sup> meqë i gjithë importi nga Selaniku duhej të ndërpritej dhe të shqyrtohen r-uta të tjera shumë më të kushtueshme.<sup>14</sup>

Ky nuk është incidenti i parë i kësaj natyre i cili ndikonte mbi stabilitetin energjetik të vendit. Në fund të vitit 1993 autoritetet në Athinë e bllokuan një tanker të plotë me naftë të dedikuar për Maqedoninë, në këtë mënyrë duke e sinjalizuar embargon e plotë tregtare e cila pasoi disa muaj më vonë.<sup>15</sup>

Sot, Maqedonia gjendet në një fqinjësi më të parashikueshme dhe më stabile të gërshetuar në proceset integruese të NATO-s dhe BE-së. Vendi, si i këtillë, në masë të madhe i ndan shumicën e shqetësimeve të cilat i tangojnë shtetet e tjera evropiane ku furnizimi me gaz u bë sinonim i sigurisë energjetike duke i shpërfillur llojet e tjera të energjisë.

Në Maqedoni, në vitin 2010, gazi natyror ka marrë pjesë me vetëm 1,7% në konsumin final të energjisë<sup>16</sup>, diçka që duhet të perceptohet seriozisht kur bëhet fjalë për rolin e gazit natyror në sigurinë energjetike maqedonase dhe skenarët e mundshëm negativ në rast të ndërprerjes së furnizimit me gaz. Nëse, megjithatë, një gjë e këtillë ndodhë, kjo fillimisht do të ndihet në sektorin industrial i cili, në një pjesë të prodhimit dhe punës së vet, mbështetet mbi gazin natyror, por edhe për shkak të faktit se konsumi i gazit tek ekonomitë familjare është mjaft më i vogël. Megjithatë, duhet ta theksojmë edhe atë se autoritetet maqedonase janë gjithnjë e më të zëshëm në qëllimet e tyre për gazifikimin e shtetit dhe së këtejmi debati në këtë temë duhet të bëhet me kohë, me qëllim që të zbuten rreziqet e mundshëm.

Ekspertët e fushës së energjetikës vazhdimisht e bindin publikun që madje edhe nëse shfaqet dukuri, me ç'rast

<sup>11</sup> Deklarata për sigurinë e furnizimit, Republika e Maqedonisë, (2013), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/2422179.PDF>

<sup>12</sup> Islam Jusufi, Maqedonia në: M. Haxhiq, M. Timotiq, P. Petroviq, redaktorë, Politikat e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, (2010)

<sup>13</sup> Dimitrov Petre. Embargo për fqinjësi të "mirë": Sa ishin dëmet nga embargoja greke" E Magazina. 8 shtator, 2014. Vizituar më 1 tetor, 2014. <http://emagazin.mk/embargo-za-dobro-sosedstvo-kolkav/>.

<sup>14</sup> "Bllokada maqedonase" 11 shkurt, 1996. Vizituar më 25 gusht, 2014. <http://www1.american.edu/ted/macedon.htm>.

<sup>15</sup> "20 vjet nga embargoja tregtare greke". Lider ekonomik. Shkurt 16, 2014. Vizituar më 9 gusht, 2014.

[http://lider.mk/2014/02/16/20-godini-od-grcko\[-trgovsko-embargo/](http://lider.mk/2014/02/16/20-godini-od-grcko[-trgovsko-embargo/).

<sup>16</sup> "Statistika energjetike 2000-2010 Pasqyra statistikore: Industria dhe energjia" Enti Shtetëror i Statistikës të Republikës së Maqedonisë, 2012, Shkup, Vizituar më 23 tetor, 2014 <http://www.stat.gov.mk/publikacii/6.4.12.01.pdf>

tërësisht do të ndërpritej furnizimi me gazin rus, si ajo e vitit 2009, Maqedonia nuk do të ndjente pasoja negative dramatike.<sup>17</sup> Ky mendim shkon në drejtim të fokusimit të idesë se përdorimi i gazit natyror në Maqedoni është relativisht i ulët dhe se rrjeti tanimë ekzistues i tubacioneve të gazit është larg arritjes së kapacitetit të tij të plotë – 800 milionë m<sup>3</sup> në nivel vjetor.<sup>18</sup> Shifrat flasin se në vitin 2013, për shembull, vetëm 130 m<sup>3</sup> janë transportuar përmes këtij rrjeti.<sup>19</sup> Megjithatë, projektet e paralajmëruara të mëdha infrastrukturore, duke e përfshirë edhe ndërtimin e rrjeteve plotësuese të gazsjellësve, të cilët shtrihen në tërë shtetin, si dhe rritja e konsumit të këtij burimi energjetik nga ana e sektorit industrial e vë në pah atë se kërkesa e gazit natyror ka potencial të rritet.

Kështu, për shembull, autoritetet maqedonase paralajmëruan tenderë për gazifikimin e zonave qendrore, lindore dhe perëndimore të Maqedonisë, si dhe Shkupin si kryeqytet gjë që e vë në pah atë se në afat të mesëm rrjeti do të ketë nevojë për më shumë gaz, ndërkaq veçanërisht kur ekonomitë familjare do të fillojnë të lidhen në rrjet. Në lidhje me këtë tanimë u bënë ndryshime në zgjidhjet ligjore tek Ligji për ndërtim, i cili për herë të parë parashikon se ndërtimet e reja duhet të kenë edhe lidhje për gaz.<sup>20</sup>

### 2.1 Kriza në Ukrainë


Për momentin, ngjarjet politike dhe ekonomike të cilat kanë potencial dhe mund ta destabilizojnë livrimin e sigurt të gazit në Evropë, megjithatë mund të ndikojnë mbi Maqedoninë janë kryesisht ngjarje rreth krizës në Ukrainë. Vetëm për disa vjet kontinenti i Evropës dëshmoi për një numër të konsiderueshëm të ndërprerjeve të livrimit të gazit të cilat ishin si rezultat i konflikteve të pazgjdhura ekonomike dhe deri diku edhe politike me Rusinë, e cila është eksportuesja më e madhe e gazit natyror në Evropë. Me disa dimra problematik, problemet e livrimit të gazit nuk

e targetojnë vetëm BE dhe Rusinë por gjithnjë e më shpesh edhe vendet e treta siç është Ukraina, qendra më e rëndësishme energjetike e Evropës, e cila i lidh gazsjellësit rus me konsumatorët evropianë.

Kontestet e gazit midis Risisë, Ukrainës dhe Bashkimit Evropian	
Tetor – 2007	Mars – Prill 1994
Mars – 2008	Janar – 2001
Janar – 2009	Janar – 2006

Burimi: Nova Makedonia/RIA Novosti<sup>21</sup>

### Foto 2: Importi i gazit nga Rusia në vitin 2012



Burimi: AI Sours, vizituar më 20 tetor 2014

<http://www.aisource.com/managed-futures/news/aisource-news/2014/04/24/march-2014-global-macro-recap>

Përveç potencialit për reduktim ose për ndërprerjen e plotë të furnizimit me gazin rus, jostabiliteti në Ukrainë (politikë dhe territorial) ka potencial të ndikojë edhe mbi çmimet e burimeve energjetike.<sup>22</sup> Në një sërë studimesh në të cilat analizohet mundësia e ndikimit mbi reduktimin ose ndërprerjen e gazit rus për Evropë tregojnë se vendet më të goditura fillimisht do të jenë vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, duke e përfshirë edhe

<sup>17</sup> "Ekspertët demantojnë: Nëse ka krizë gazi, Maqedonia nuk rrezikohet!" Veçer, 17 tetor, 2014. Vizituar më 18 tetor, 2014. <http://vecer.mk/ekonomija/ekspertite-demantiraat-ako-ima-gasna-kriza-makedonija-ne-e-zagrozena>

<sup>18</sup> Komisioni Rregullator i Energjetikës, "Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013", (2014) Vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20raborta%20na%20Regulatornata%20komisija%20za%20energetika%20na%20RM%20za%202013%20godina.pdf>

<sup>19</sup> Pavloviq, Zdenka. "Konzorciumi i kompanive evropiane dhe amerikane dëshiron ta blejë gazsjellësin ukrainas?" Dnevnik, 9 Qershor, 2013. Vizituar më 4 shtator, 2014. <http://www.dnevnik.mk/?ItemID=27EBB47AC5E5174EB7AC03F1542A8C35>.

<sup>20</sup> "Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërtim." Neni 11a. "Gazeta Zyrtare 115/14, Vizituar më 23 tetor, 2014:

[http://www.komoraoui.mk/gallery/Zakonski%20akti/SI.V.115\\_od\\_01.08.14.pdf](http://www.komoraoui.mk/gallery/Zakonski%20akti/SI.V.115_od_01.08.14.pdf)

<sup>21</sup> Nikolovski, Vladimir dhe Maja Trajkovska. "Nga loja me rubinete e pësojnë ekonomitë." Nova Makedonija, 12 prill 2014. Vizituar më 27 shtator, 2014.

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=411141655508&id=10&prilog=0&setIzdanie=23150>.

<sup>22</sup> "BPRM: Kriza ukrainase mund të ndikojë mbi ekonominë maqedonase." Faktor. 16 mars, 2014. Vizituar më 4 shtator, 2014.

[http://faktor.mk/archives/99430?utm\\_source=rss&utm\\_medium=rss&utm\\_campaign=nbrm-ukrainaskata-kriza-mozhe-da-vlijae-na-makedonskata-ekonomija](http://faktor.mk/archives/99430?utm_source=rss&utm_medium=rss&utm_campaign=nbrm-ukrainaskata-kriza-mozhe-da-vlijae-na-makedonskata-ekonomija)





Maqedoninë ku varësia nga gazi rus është në shkallë më të lartë dhe arrin madje 100%.<sup>23</sup>

Sipas stres-testit të zbatuar nga BE, Maqedonia është në grupin e pesë vendeve evropiane (bashkë me Finlandën, Estonin, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbinë) që do të ishin më të prekura nga ndërprerja eventuale e gazit rus.<sup>24</sup> Megjithatë, kur Maqedonia krahasohet me vendet e tjera të listës, vendi dëshmon nivel ekstremisht të ulët të varësisë nga gazi natyror. Pjesa më e madhe e ekonomive familjare në Maqedoni përdorin energji elektrike, si dhe dru zjarri që t'i përmbushin nevojat e tyre energjetike.

Potenciali nga pasiguria e gazit mund të locohet në rritjen e vogël të gazsjellësit, i cili e bën livrimin e gazit kryesisht për objektet industriale. Si i këtille ai është mjaft fragjil ndaj goditjeve politike/ekonomike duke e pasur parasysh atë se gazi në Maqedoni tërësisht vjen nga Rusia dhe kalon përmes Bullgarisë. Serioziteti i jostabilitetit në Ukrainë, e cila është në një pozitë të këtille thuaja se një vit, i tregoi druajtjet se kontinenti evropian ndoshta do të duhet të përballet edhe me një krizë të gazit, si ajo e vitit 2006 dhe 2009.

**Kriza e gazit në vitin 2009** midis Rusisë dhe Ukrainës e arriti kulmin kur Gazpromi i mbylli rubinetet e gazit duke lënë një pjesë mjaft të madhe të Evropës Qendrore dhe Lindore pa furnizim normal me këtë burim energjetik. Kievi dhe Moska akuzoheshin mes tyre duke tentuar ta dëshmojnë anën e tyre të rrëfimit, ndërkaq shumë ekonomi familjare në Evropë kërkonin burime alternative të energjisë për ngrohjen e shtëpive të tyre. Qytetarët e Bullgarisë fqinje, për shembull, mbetën pa ngrohje qendrore dhe ishin drejtpërdrejtë të tanguar nga kriza e gazit, e cila rezultoi me mbylljen e një pjese të shkollave dhe kopshteve për fëmijë derisa zgjati kriza.<sup>25</sup>

<sup>23</sup> Kovačević, Aleksandar, "Ndikimi i krizës ruso-ukrainase e gazit në Evropën Juglindore", Instituti për studime energjetike-Oksford 2009, Vizituar më 23 tetor, 2014

<http://www.oxfordenergy.org/wpcms/wp-content/uploads/2010/11/NG29-TheImpactoftheRussiaUkrainianCrisisinSouthEasternEurope-AleksandarKovacevic-2009.pdf>

<sup>24</sup> "KE: Maqedonia në mesin e pesë vendeve më të rrezikuara në Evropë nëse ndërpritet gazi rus" 24 Vesti. 16 tetor, 2014. Vizituar më 16 tetor, 2014. <http://24vesti.mk/ek-makedonija-megju-pette-najzagrozeni-zemji-vo-evropa-ako-zapre-ruskiot-gas>.

<sup>25</sup> "Evropa dridhet nga të ftohtit ndërsa Rusia e shkurtoi livrimin e gazit." NBC Vesti. 7 janar, 2009. Vizituar më 3 tetor, 2014. [http://www.nbcnews.com/id/28515983/ns/world\\_news-europe/t/europeans-shiver-russia-cuts-gas-shipments/#.VEIX2YcRa-9](http://www.nbcnews.com/id/28515983/ns/world_news-europe/t/europeans-shiver-russia-cuts-gas-shipments/#.VEIX2YcRa-9).

<sup>26</sup> Nikollovski Vlladimir dhe Maja Trajkovska. "Nga loja me rubinete pësojnë ekonomitë." Nova Makedonija, 12 prill, 2014. Vizituar më 27 shtator, 2014.

Njëra nga krizat më dramatike të gazit në historinë më të fundit ndodhi më 1 janar të viti 2009 kur Rusia vendosi ta ndërpres furnizimin me gaz në drejtim të Ukrainës dhe Evropës. Një javë më vonë autoritetet ukrainase gjithashtu vendosën ta ndërpresin transitin në drejtim të konsumatorëve evropianë.<sup>26</sup> Që atëherë, ngjarjet në Ukrainë u përkeqësuan. Korridori më i madh transit evropian i gazit u fut në luftë civile e cila fillimisht filloi me protesta të qeta kundër vendimit të Presidentit të atëhershëm Janukoviç që ta refuzojë nënshkrimin e Marrëveshjes tregtare me BE kah fundi i vitit 2013.

Kjo, më vonë, rezultoi me krijimin e ndarjeve të thella në indin e shoqërisë ukrainase, kështu duke e ndarë vendin në dy blloqe, ata të cilët i mbështetnin lidhjet më të afërta me Brukselin dhe ata të cilët shikonin me simpati të madhe kah Moska. Pastaj, këto ndarje rezultuan në konflikt të brendshëm ushtarak, para së gjithash në pjesët lindore të Ukrainës. Inkuadrimi i fshehtë rus në këtë konflikt dhe aneksimi i hapur i Krimesë në mënyrë plotësuese i rëndon edhe ashtu marrëdhëniet e brishta midis Moskës dhe Kievit, të cilat shumë lehtë mund të përshkallëzohen edhe në frontin e gazit, duke e pasur parasysh atë se madje gjysma e importit të gazit rus në BE vjen përmes Ukrainës.<sup>27</sup> Kjo i ndërlihet faktit se BE nuk është prodhues i madh i gazit ku prej të gjitha vendeve anëtare vetëm Danimarka, Britania e Madhe, Gjermania, Italia dhe Rumania kanë kapacitete prodhuese të kufizuara të gazit.<sup>28</sup> Përveç nga Rusia, Bashkimi Evropian importon gaz edhe nga Norvegjia dhe Algjeria. Megjithatë, mbështetja mbi importin nga këto shtete mund të jetë opsion afatshkurtër për shkak të kufizimeve të tyre ekzistuese, si nga aspekti politik, teknik ashtu edhe nga aspekti i resurseve.<sup>29</sup>

Pavarësisht mospajtimeve politike dhe ekonomike, të cilat kanë mundësi të ndikojnë mbi livrimin e gazit rus në Evropë, rreziku nga rritja e dhunës në Ukrainë mund të çojë deri në dëmtime fizike të gazsjellësve të cilët kalojnë përmes territorit të saj. Në muajin qershor disa shpërthime shkaktuan dëme mbi gazsjellësin Trans-

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=411141655508&id=10&prilog=0&setIzdanie=23150>.

<sup>27</sup> "Maqedonia, Bullgaria dhe Rumania më fragjile nga gazi rus." Utrinski vesnik, 18 mars, 2014. Vizituar më 26 korrik, 2014. <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=3281D9D3B06F6141ABE125B056200AE7>

<sup>28</sup> ibid.

<sup>29</sup> Norvegjia për një nuancë mund ta rris furnizimin me gaz në BE" Lokal. 26 shtator, 2014. Vizita e fundit 6 tetor, 2014. <http://www.thelocal.no/20140926/norway-can-slightly-boost-gas-to-russia-reliant-eu>.



Siberian në afërsi të lokalitetit Poltava në lindje të Ukrainës. Kjo ngjarje u vlerësua menjëherë nga Ministria për Energjetikë e Ukrainës si akt terrorist.<sup>30</sup> Çfarë rëndësie strategjike ka rrjeti i gazsjellësit në Ukrainë mund të shihet përmes shembullit ku forcat e armatosura ukrainase, në tentativë për të mbrojtur një pjesë të gazsjellësit, lëshuan parashutistë në afërsi të stacionit të pompimit në afërsi të fshatit Stilkove (në veri të Krimesë).<sup>31</sup>

Besueshmëria për zgjidhje të shpejtë të konfliktit ukrainas është e vogël, ndërkaq konfrontimet e drejtpërdrejta me autoritetet e Moskës, ku gazi akoma perceptohet si instrument për fuqi politike, në mënyrë të drejtpërdrejtë mund ta rrezikojë furnizimin me gaz në Evropë edhe gjatë këtij dimri. Gazpromi rus haptas e vë në pah këtë mundësi meqë "... [Gazprom] nuk do të ishte në pozitë të parandalojë ndërprerjen eventuale të gazit i cili tranziton përmes territorit të Ukrainës, Bjellorusisë dhe Moldavisë.<sup>32</sup> Akuzat e ndërsjella midis Moskës dhe Kievit nuk janë të reja, të cilat si të atilla ishin të pranishme edhe në krizat e mëparshme të gazit, me ç'rast konsumatorët evropian ishin drejtpërdrejtë të goditur.

## 2.2 Rrjedha Jugore

Përderisa kriza ukrainase është në vllugun e plotë, spektri i ngjarjeve kontroverse rreth ndërtimit të projektit të madh energjetik rus "Rrjedha Jugore", në mënyrë plotësuese e komplikojnë imazhin energjetik në Evropë.

Ky gazsjellës, në mënyrë të konsiderueshme, duhet ta ndihmojë idenë ruse për pavarësinë e rrjedhës së gazit nga territori i saj në drejtim të konsumatorëve evropian përmes anashkalimit të Ukrainës, si vend transit. Gazsjellësi, i cili duhet të livrojë gaz rus deri në Evropën Juglindore dhe Qendrore, ballafaqohet me një sërë problemesh në implementimin e tij, që para së gjithash kanë të bëjnë me mosharmonizimin e tij ligjor me atë të BE-së. Për këtë

shkak, nënshkrimi i marrëveshjes si dhe fillimi i punimeve zvarritej, nga njëra anë projekti përballet me një sërë sfidash të natyrës juridike, ndërtimi i këtij gazsjellësi mjaft të rëndësishëm dhe koincidenca me krizën në Ukrainë, nga ana tjetër, gjithnjë e më shumë i japin rëndësi më të madhe politike. Federika Mogerini, shefja e re e diplomacisë evropiane në prononcimin e saj, sa i përket "Rrjedhës Jugore", porositi se: "...Rrjedha Jugore është imagjinuar në një kohë tjetër dhe mund të kontribuojë në drejtim të diversifikimit të rutave, nëse vetëm përveç kushteve teknike i plotëson edhe ato politike."<sup>33</sup>

Maqedonia është njëri nga vendet e cila duhet në mënyrë të tërthortë të ketë përfitime nga ndërtimi i tij. Duke e pasur parasysh atë se Maqedonia nuk ka shumë mundësi për lidhje në gazsjellës të tjerë, autoritetet në Shkup vendosën ta rrisin edhe më shumë varësinë nga gazi rus përmes kontraktimit të marrëveshjes e cila do të duhet ta vazhdojë "Rrjedhën Jugore" me një degë përmes Bullgarisë ose përmes Serbisë, diçka që për momentin akoma nuk është vendosur. Ndërtimi i gazsjellësit duhet pjesërisht të financohet nga Rusia me marrëveshjen për borxhin e kliringut midis të dy vendeve, i arritur në vitin 2010. Në kushte të këtylla varësia e Maqedonisë nga gazi nga një burim i vetëm rritet në mënyrë dramatike por njëkohësisht sigurohet një furnizim në masë të konsiderueshme më i madh i gazit. Duke e marrë parasysh atë se negociatat rreth ndërtimit të këtij projekti nuk zhvillohen me kapacitet të plotë, kjo paraqet mundësi të mirë që autoritetet në Shkup të vazhdojnë të kërkojnë opsione të tjera, si për shembull, ai për lidhjen në gazsjellësin Trans-Adriatik i cili duhet të transportojë gaz nga Azerbajxhani përmes Greqisë dhe Shqipërisë, që në fund të arrijë në Bregdetin Adriatik dhe Itali. Nëse ndërmerren hapa konkret në këtë drejtim, në masë të konsiderueshme do të reduktohet varësia e Maqedonisë vetëm nga një burim dhe do të kontribuojë për akses më të mirë deri te gazi për konsumatorët maqedonas, të cilët duhet të kenë edhe çmime më të ulëta. Koncepti kryesor i gazifikimit të vendit po ashtu, parashikon mundësi për lidhjen e secilit nga vendet fqinje, që ofron mundësi për diversifikimin e mëtejshëm.<sup>34</sup>

<sup>30</sup> "Gazsjellës i madh ukrainas goditet nga eksplodimi." BBS. 17 qershor, 2014. Vizituar më 3 tetor, 2014.  
<http://www.bbc.com/news/world-europe-27891018>.

<sup>31</sup> MekElroj, Damjan, Jekaterina Kravstsova dhe Roland Olifant. "Forca të armatosura ruse në Ukrainë kundrejt referendumit të Krime." Telegraf, 15 mars, 2014. Vizituar më 20 tetor, 2014.  
<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/ukraine/10700496/Russian-troops-in-mainland-Ukraine-ahead-of-Crimea-vote.html>.

<sup>32</sup> "Nuk përjashtohet mundësia për ndërprerjen e tranzitimit të gazit rus për Evropën". Veçer, 30 Prill, 2014. Vizituar më 4 tetor, 2014.  
<http://vecer.com.mk/?ItemID=BA60E10CE99F364A951375C609F0ACF6>.

<sup>33</sup> "Mogerini: Rusia nuk është më partner strategjik i BE." Njuz Jupor. 4 shtator 2014. Vizituar më 16 tetor, 2013.

<http://newseurope.me/2014/09/04/mogherini-russia-longer-eus-strategic-partner/>

<sup>34</sup> Taleska, Petranka. "Sa më shumë import çmime aq më të ulëta të gazit rus." Nova Makedonija, 14 prill, 2014. Vizituar më 20 gusht, 2014

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=41314178274&id=10&prilog=0&setIzdanie=23151>.



### 3. Rreziqet vendase - rreziqe të cilat rezultojnë në relacion me prodhimin vendas dhe transformimin e energjisë

#### 3.1 Katastrofa natyrore dhe katastrofa të tjera

Faktorët të cilët ndikojnë mbi sigurinë energjetike janë katastrofat e mundshme – të shkaktuara nga faktori njeri ose natyra. Maqedonia ka një sërë të institucioneve të ndryshme dhe ka miratuar një varg të akteve normative për rregullimin e mbrojtjes nga katastrofat. Njëri nga institucionet më relevante është Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, e cila merret me mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera, siç është theksuar në Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim.<sup>35</sup> Pastaj, Ligji për menaxhimin me kriza i thekson si rreziqe dhe risqe të mundshme të jenë pasojë nga konflikti i interesave në aspekt të shfrytëzimit të rrugëve dhe të burimeve strategjike të energjisë, si dhe bllokimi i importit të tyre në vend, katastrofat natyrore, katastrofat teknike-teknologjike etj.<sup>36</sup> Gjithashtu, çdo operator, si operator i sistemit të elektro-transmisionit ose i sistemit të furnizimit me gaz ose i sistemit të shpërndarjes, duhet të miratojë rregulla të rrjetit të cilat, mes tjerash, i rregullojnë masat në rast të avarive.<sup>37</sup>

Akt normativ relevant sekondar, në lidhje me sigurinë energjetike, është Urdhëresa për kriteret dhe kushtet për shpalljen e gjendjes së krizës elektro-energjetike. Këto kushte e përfshijnë kolapsin ose kolapsin e pjesëshëm të sistemit elektro-energjetik në Maqedoni, kolaps të sistemit elektro-energjetik në vendet fqinje, probleme me kapacitet e transmetimit dhe me probleme me kapacitetet më të mëdha prodhuese dhe mungesë të energjisë elektrike.<sup>38</sup> Çështja me mungesën e furnizimit me gaz natyror trajtohet në Rregullat e rrjeteve për

transmetimin e gazit natyror, me ç'rast përshkruhet se kriza mund të jetë gjendje në të cilën transmetimi ose furnizimi me gaz natyror është penguar.<sup>39</sup> Një akt normativ mjaft i rëndësishëm është Urdhëresa për kriteret dhe kushtet për shpalljen e gjendjes së krizës gjatë furnizimit me gaz natyror. Kriteret për shpalljen e krizës së këtyllë përfshijnë pengimin e pjesëshëm të furnizimit me gaz natyror, temperatura ditore ekstreme të ulëta dhe periudha të kërkesave të mëdha të gazit natyror gjatë kohës së dimrave më të ftohtë.<sup>40</sup> Përveç faktit se legjislacioni relevant për sigurinë energjetike është miratuar edhe sa i përket energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke e vlerësuar sipas konsumit final të energjisë (krahaso Tabelat 2 dhe 3), energjia elektrike luan rol më të rëndësishëm. Në krahasim me energjinë elektrike, pjesëmarrja e gazit natyror, në konsumin final të energjisë në vitin 2010, është 19 herë më i vogël nga ai i energjisë elektrike.<sup>41</sup> Megjithatë, sa u përket angazhimeve maqedonase për rritjen e pjesëmarrjes së gazit natyror, siç mund të shihet në Tabelën 1 e cila thotë se nga viti 2009 deri në vitin 2013 importi i gazit natyror thuaja se është dyfish më i madh; veçanërisht rekomandohet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së përgjithshme me furnizimin me gaz natyror, veçanërisht nga aspekti i sigurisë.

**Tabela 1: Gazi natyror i importuar gjatë viteve 2009-2013 në 000 nm3**

Gazi natyror i importuar në 000 nm3	Viti
79762.942	2009
118 396.526	2010
136671.228	2011
141557.264	2012
159502.542	2013

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave<sup>42</sup>

<sup>35</sup> "Ligji për mbrojtje dhe shpëtim" "Gazeta Zyrtare" 93/12, vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/1F2D347B699C764F9E65C717889E74B2.pdf>

<sup>36</sup> "Ligji për menaxhim me kriza" "Gazeta Zyrtare" 29/05, vizita e fundit më 23 tetor 2014

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/2B55BCB15891E144B555BA0302455CB6.pdf>

<sup>37</sup> "Ligji për energjetikë" "Gazeta Zyrtare" 16/11, vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/EE982E53C03DAB4C982055F184E70F66.pdf>

<sup>38</sup> "Urdhëresë për kriteret dhe kushtet për shpalljen e gjendjes së krizës energjetike, mënyra e furnizimit me energji elektrike në këto kushte, masat që ndërmerren në rast të gjendjes së krizës, si dhe të drejtat dhe obligimet e bartësve të licencave për kryerjen e veprimtarive energjetike", "Gazeta Zyrtare" 53/12, vizituar më 24 tetor 2014

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/30A0E542205D7E4B9E4E8384E6CEE0D2.pdf>

<sup>39</sup> "Rregullat e rrjetit për transmetimin e gazit natyror", "Gazeta Zyrtare" 45/09, vizituar më 24 tetor 2014

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/0145DC355953F340BB9BD13F8D098B80.pdf>

<sup>40</sup> "Urdhëresë për kriteret dhe kushtet për shpalljen e gjendjes së krizës energjetike, mënyra e furnizimit me energji elektrike në këto kushte, masat që ndërmerren në rast të gjendjes së krizës, si dhe të drejtat dhe obligimet e bartësve të licencave për kryerjen e veprimtarive energjetike", "Gazeta Zyrtare" 143/13, vizituar më 24 tetor 2014

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/4f20fda93c38442d878c6977defee7f5.pdf>

<sup>41</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, "Statistika energjetike 2000-2010 Pasqyrë statistikore: Industria dhe energjia, Enti Shtetëror i Statistikës, 2012, Shkup, vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/publikaci/6.4.12.01.pdf>  
<sup>42</sup> Burime: Enti Shtetëror i Statistikës, "Balance energjetike 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014  
<http://www.stat.gov.mk/pdf/2014/6.1.14.79.pdf>; Enti Shtetëror i





Gjatë shqyrtimit të sigurisë së infrastrukturës energjetike, është me rëndësi të theksohet se energjia bërthamore ndoshta është lloji i energjisë për të cilin diskutohet më së shumti lidhur me sigurinë dhe rreziqet. Energjia bërthame bart me vete edhe: rreziqe shëndetësore dhe të sigurisë – rreziqe të sëmundjeve të njerëzve dhe kafshëve, si rezultat i rrezatimit madje mund të jetë edhe qëllim potencial për sulme.<sup>43</sup> Strategjia Energjetike Maqedonase pohon se zhvillimi i programit bërthamor mund të jetë njëra nga mënyrat për sigurimin e energjisë së nevojshme për periudhën kohore 2020-2030. Opsioni bërthamor mund të sigurojë diversifikim të rritur, dhe me këtë edhe siguri të rritur gjatë furnizimit me energji elektrike.<sup>44</sup> Megjithatë, deri më tani nuk kemi vendim për ndërtimin e Centralit Bërthamor në Maqedoni, kështu që kjo është një fushë e cila aktualisht nuk është prioritare në agjendë.

### 3.2 Vërshimet

"Rreth 111000 konsumatorë u goditën me ndërprerjen e energjisë elektrike në 29 komuna si rezultat i vërshimeve. Midis 15 dhe 19 majit të vitit 2014 nga rritja e nivelit të ujit në lumin Kollubara dhe degët e saj Vraniçina dhe Prestan i vërshuan vendburimet në Tamnava Perëndim, Veliki Crijeni, si dhe Sektorët B dhe D të vendburimit të thëngjillit Kollubara."<sup>45</sup>

Resurset energjetike, si dhe infrastruktura energjetike janë fragjil dhe u ekspozohen ndryshimeve klimatike dhe katastrofave natyrore. Vërshimet të cilat, në vitin 2014, e përfshinë Ballkanin Perëndimor, më saktë Serbinë Kroacinë

Statistikës, "Bilance energjetike 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2013/6.1.13.87.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2011", (2012), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/6.1.12.82.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2010", (2011), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/6.1.12.38.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2009", (2011), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2011/6.1.11.53.pdf>

<sup>43</sup> Sonja Risteska, Natasha Hroneska, Gjelbërimi i sektorit energjetik – A i nevojitet Maqedonisë energji bërthamore?, Analitika, 2010, vizituar më 24 tetor 2014 [http://www.analyticamk.org/images/stories/files/report/papers/paper\\_3.pdf](http://www.analyticamk.org/images/stories/files/report/papers/paper_3.pdf)

<sup>44</sup> Ministria e Ekonomisë e Republikës së Maqedonisë, "Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030", (2010), vizituar më 23 tetor 2014 [http://www.ea.gov.mk/images/stories/E\\_Izdanija/Energetika\\_Strategjia\\_za\\_energetika\\_na\\_RM\\_do\\_2030\\_SV\\_61\\_2010\\_244131\\_078.pdf](http://www.ea.gov.mk/images/stories/E_Izdanija/Energetika_Strategjia_za_energetika_na_RM_do_2030_SV_61_2010_244131_078.pdf)

<sup>45</sup> Qeveria e Republikës së Serbisë. "Serbia vërshimet 2014". Vizituar më 10 tetor 2013. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press\\_corner/floods/20140715-serbia-rna-report.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/floods/20140715-serbia-rna-report.pdf) f. 12

dhe Bosnjë e Hercegovinën e treguan karakterin e tyre destruktiv. Për shembull, në Serbi vërshimet e pamundësuan eksploatimin e thëngjillit, i cili ndikon drejtpërdrejtë mbi prodhimin e energjisë elektrike. Dy prej vendburimeve të tyre të thëngjillit u vërshuan dhe prodhimi i mëtutjeshëm i rrymës nuk ishte i mundshëm për një kohë të caktuar kohore.<sup>46</sup> Dëmi ndaj sektorit energjetik në Serbi, si rezultat i vërshimeve, përfshirë këtu edhe vendburimin e thëngjillit, vlerësohet në 488 milionë Euro.<sup>47</sup>

### 3.3 Zjarret

Zjarret, po ashtu, kanë potencial ta pengojnë shpërndarjen e energjisë elektrike. Kjo është veçanërisht rast me zjarret pyjore të cilët kanë potencial për përhapje të shpejtë dhe përfshirjen e zonave të mëdha gjeografike dhe nëse nuk lokalizohen me kohë ka mundësi për dëmtime serioze të sistemeve ekzistuese të transmetimit të energjisë elektrike. Popullata lokale, e cila jeton në afërsi të zonës të përfshirë nga zjarri, është e mundshme se do të ballafaqohet me ndërprerje periodike të furnizimit me energji elektrike për shkak të dëmtimeve në atë pjesë të rrjetit, ndërsa edhe për shkak të vendosjes së kontrollit ndaj zjarrit, (për shembull: përdorimi i avionëve për fikjen e zjarreve).

Vera e vitit 2007 ishte njëra nga verat më kritike për Maqedoninë në këtë aspekt, para së gjithash për shkak të intensitetit të zjarreve, ndërsa rrjedhimisht me këtë edhe efektet që i kishin të njëjtit mbi rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike. Por, nuk mundet plotësisht të përjashtohet faktori njeri për shkaqet e zjarreve, megjithatë temperaturat jashtëzakonisht të larta (mbi 40 gradë celsius) e luajtën rolin e tyre. Përveç zjarreve, të cilat i përfshin shumë vende nëpër Maqedoni, një numër i madh i zjarreve u regjistruan edhe në vendet fqinje të cilat kishin ndikim të tërthortë mbi rrjetin elektrik maqedonas.

Një avari e konsiderueshme ndodhi më 25 korrik të vitit 2007 kur një numër i madh i shfrytëzuesve të energjisë elektrike, në mbarë vendin, mbetën në errësi për rreth dy orë. Shkak i kolapsit u konstatua në avarinë e linjës së transmetimit Bllagoevgrad (Bullgari) dhe Selanik (Greqi). Në kushte të këtylla sistemi elektrik grek ka tërhequr një sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike përmes rrjetit transmetues maqedonas që edhe e shkaktoi avarinë. Zjarret

<sup>46</sup> Ibid.


<sup>47</sup> Mileunsnic, Dragana. "Reforma të komunitetit të energjisë: Për çka do të insistojë BE?" Euroaktiv, 26 gusht, 2014. Vizituar më 24 shtator, 2014. <http://www.euractiv.com/sections/energy/energy-community-reform-what-will-eu-push-307969>.

pyjorë si dhe niveli i ulët i prodhimit vendas të energjisë elektrike gjithashtu u apostrofuan si shkak për këtë ngjarje nga ana e drejtorit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Maqedonase (MEPSO).<sup>48</sup>

### 3.4 Liberalizimi energjetik

Në vitin 2006 Maqedonia e ratifikoi Marrëveshjen për themelimin e komunitetit energjetik,<sup>49</sup> e cila ka për qëllim t'i organizojë marrëdhëniet midis palëve dhe të krijojë kornizë juridike dhe ekonomike me qëllim që, mes tjerash, të krijojë kornizë stabile rregulatore dhe të tregut, e aftë për absorbimin e investimeve në rrjetet gazsjellës, prodhimin e energjisë elektrike dhe rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, ta përmirësojë sigurinë e furnizimit. etj.<sup>50</sup> Kjo Marrëveshje parashikonte liberalizimin e tregut për të gjitha jo-ekonomitë familjare nga 1 janari i viti 2008 dhe liberalizimin e tregut për të gjithë konsumatorët nga 1 janari i vitit 2015.

#### Grafiku 1: Çmimi mesatar i energjisë elektrike për ekonomitë familjare të lidhura në sistemin e shpërndarjes gjatë periudhës kohore 2009-2013 në denarë/kWh



Burimi: Komisioni Rregullator i Energjetikës<sup>51</sup>


<sup>48</sup> Petreski, Goran. "Kolaps afatshkurtër energjetik." Dojçe Vele. 25 korrik, 2007. Vizituar më 4 shtator, 2014. <http://www.dw.de/краткотраен-енергетски-колапс/a-2705779>.

<sup>49</sup> "Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e komunitetit energjetik", "Gazeta Zyrtare 59/ 06, vizituar më 24 tetor 2014 <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/850A30DA5426AD449FDF7009F36B13DE.pdf>

<sup>50</sup> Internet faqja e Komunitetit Energjetik/ Marrëveshja (2014), vizituar më 23 tetor 2014 [http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC\\_HOME/ENERGY\\_COMMUNITY/Legal/Treaty](http://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Treaty)

<sup>51</sup> Komisioni Rregullator i Energjetikës, "Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë në vitin 2010", (2011), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/IZVESTAJ%20ZA%20RABOTATA%20NA%20RKE%20VO%202010%20GODINA.pdf>; Komisioni Rregullator i Energjetikës, "Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë në vitin 2011", (2012), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatore%20komisija%20za%20energetika%20za%202011%20godina.pdf>; Komisioni Rregullator i

#### Grafiku 2: Përqindja e ekonomive familjare të intervistuar të cilat kanë mundësi në mënyrë adekuate ta ngrohin shtëpinë e tyre



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave<sup>52</sup>

Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike e nënkupton rritjen graduale të çmimit të energjisë elektrike që ta arrijë çmimin e tregut, prandaj ndër vite çmimi i energjisë elektrike në Maqedoni shënonte rritje ashtu siç mund të shihet në Grafikon 1 për ekonomitë familjare. Meqë ekonomitë familjare, në masë të madhe, mbështeten në energjinë elektrike për përmbushjen e nevojave të tyre energjetike, siç mund të shihet në Tabelën 2, në masë më të madhe edhe industria shfrytëzon energji elektrike, siç mund të shihet në Tabelën 3; rritja e çmimit të energjisë elektrike fuqishëm mund të godasë një pjesë të madhe të konsumatorëve të energjisë. Fragjiliteti i ekonomive familjare mund të shihet nga përgjigjet e tyre për aftësinë e tyre në mënyrë adekuate t'i ngrohin shtëpitë (duke e pasur parasysh faktin se energjia elektrike në masë të madhe

Energjetikës, "Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë në vitin 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatore%20komisija%20za%20energetika%20na%20RM%20za%202012%20godina.pdf>; Komisioni Rregullator i Energjetikës, "Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator të Energjetikës të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatore%20komisija%20za%20energetika%20na%20RM%20za%202013%20godina.pdf>

<sup>52</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, "Konsumi në ekonomitë familjare të Republikës së Maqedonisë 2007", (2008), vizituar më 23 tetor 2014, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/4.4.8.01.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Konsumi në ekonomitë familjare të Republikës së Maqedonisë 2008", (2009), vizituar më 23 tetor 2014, <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/4.4.9.01.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Konsumi në ekonomitë familjare të Republikës së Maqedonisë 2009", (2010), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/4.4.10.01.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Konsumi në ekonomitë familjare të Republikës së Maqedonisë 2010", (2011), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/publikacii/4.4.11.01.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Konsumi në ekonomitë familjare të Republikës së Maqedonisë 2011", (2012), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/4.4.12.01.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Konsumi në ekonomitë familjare të Republikës së Maqedonisë 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/publikacii/4.4.13.01.pdf> Enti Shtetëror i Enti Shtetëror i Statistikës, "Konsumi në ekonomitë familjare të Republikës së Maqedonisë 2013" (2014), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/4.4.14.01.pdf>



përdoret për ngrohje), kështu që në nga viti 2009 deri në vitin 2012 u zvogëluar përqindja e ekonomive familjare të afta në mënyrë adekuate t'i ngrohjin shtëpitë e tyre, siç mund të shihet në Grafikon 2. Kjo ndërlidhet me rritjen e çmimit të energjisë elektrike për atë periudhë, siç mund të shihet në Grafikon 1. Përfaqësues të komunitetit akademik e kanë ngurosur nocionin *varfëri energjetike* – përshkruhet si gjendje në të cilën ka më pak ngrohtësi në shtëpi nga minimumi subjektiv që personi të mund t'i kryejë obligimet e tij të përditshme.<sup>53</sup> Në të vërtetë, rezultatet e një studimi pohojnë se varfëria energjetike në Maqedoni mund të përfshijë madje deri në 61% nga të gjitha ekonomitë familjare në vend.<sup>54</sup>

**Tabela 2: Pjesëmarrje e energjisë elektrike në konsumin final energjetik tek ekonomitë familjare gjatë viteve 2010-2013**

Pjesëmarrje e energjisë elektrike në konsumin final energjetik tek ekonomitë familjare	Viti
51,7%	2010
52,9%	2011
53,6%	2012
58,1%	2013

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave<sup>55</sup>

Tabela 3: Pjesëmarrja e gazit natyror dhe energjisë elektrike në konsumin final të energjisë në industri gjatë viteve 2010-2013		
Pjesëmarrja e gazit natyror në konsumin final të energjisë në industri	Pjesëmarrja e energjisë elektrike në konsumin final të energjisë në industri	Viti
7%	32%	2010
6,5%	33,6%	2011
3,6%	33,6%	2012
4,3%	34,5%	2013

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave<sup>56</sup>

<sup>53</sup> Stefan Buzharovski, Varfëri energjetike në vendet në tranzicion: krahasim midis Maqedonisë dhe Çekisë, Mendimi politik, viti 8, nr. 29, Shkup, (2010)

<sup>54</sup> Stefan Buzharovski, Varfëri energjetike në Evropën Lindore: gjeografi të fshehura të deprivacionit, (2007)

<sup>55</sup> Burime: Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2014/6.1.14.79.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2013/6.1.13.87.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2010", (2011), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/6.1.12.38.pdf>

<sup>56</sup> Burime: Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014

Nga ana tjetër, varësia e madhe nga energjia elektrike mund ta rrezikojë sigurinë energjetike të shtetit. Në rast të dimrave shumë të ftohtë, qytetarët përdorin më shumë energji elektrike për ngrohje (vihen në përdorim më shumë kaloriferë energjetikë, ngrohen më gjatë me to, si dhe i përdorin në mënyrë shtesë krahas sobave me dru zjarri). Kjo mund të shkaktojë mungesë të energjisë elektrike, ashtu siç ndodhi kohë më parë në Maqedoni – në muajin shkurt të vitit 2012 kur Maqedonia shpalli krizë elektro-energjetike dhe si masa mbrojtëse u reduktua ndriçimi rrugor dhe kishte ndalim për shfrytëzimin e energjisë elektrike për ngrohje plotësuese.<sup>57</sup> Në këtë drejtim problem të madh paraqet shfrytëzimi i energjisë elektrike për ngrohje në mungesë të mënyrave të tjera të ngrohjes (gaz natyror, ngrohje qendrore e zhvilluar).

**Tabela 4: Energji elektrike e importuar gjatë viteve 2009-2013 në GWh**

Energji elektrike e importuar në GWh	Viti
1437.942	2009
1420.221	2010
2748.752	2011
2741.497	2012
2490.618	2013

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave<sup>58</sup>

Në të vërtetë, masat në drejtim të reformimit të tregut të energjisë termike, siç është instalimi i sobave efikase me dru zjarri, instalimi i kalorimetrave në zonat me ngrohje qendrore dhe ngjashëm, nuk janë ndërmarrë. Duhet të theksohet problemi akoma më i madh i varësisë nga

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2014/6.1.14.79.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2013/6.1.13.87.pdf>; Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2010", (2011), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/6.1.12.38.pdf>

<sup>57</sup> MIA/Idividi, "Qeveria shpalli gjendje të krizës energjetike", shkurt 13, 2012, vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.idividi.com.mk/vesti/makedonija/748029/>

<sup>58</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2014/6.1.14.79.pdf>;

Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2013/6.1.13.87.pdf>;

Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2011", (2012), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/6.1.12.82.pdf>;

Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2010", (2011), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/6.1.12.38.pdf>;

Enti Shtetëror i Statistikës, "Bilance energjetike 2009", (2011) vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.stat.gov.mk/pdf/2011/6.1.11.53.pdf>



energjia elektrike, të dhënat statistikore tregojnë se importi i energjisë elektrike rritet ndër vite dhe nga viti 2009 deri në vitin 2013 thuaja se është rritur dyfish, siç është pasqyruar në Tabelën 4.

Sa i përket procesit të gazifikimit, ai shënon hapa të ngadaltë në nivel qendror; megjithatë disa komuna kanë filluar me projekte lokale për gazifikim. Përveç asaj që projektet e avancuara lokale për instalimin e gazit natyror për ngrohje kanë dhënë rezultate pozitive për tregjet lokale të energjisë termike edhe atë për një kohë relativisht të shkurtër, disa ndryshime të Ligjit për energjetikë, nga muaji maj i vitit 2013, janë në drejtim të centralizimit të procesit të gazifikimit meqë thonë se Qeveria vendos për fillimin e procedurës për ndarjen e marrëveshjes për vendosjen e partneritetit publiko-privat për ndërtimin e sistemit të ri për shpërndarjen e gazit natyror. Ky ndryshim, nga ana tjetër, e parashton pyetjen se si kjo do të pasqyrohet mbi projektet rrjedhëse dhe mbi projektet e ardhshme lokale të gazifikimit.<sup>59</sup>

Një problem tjetër është prononcimi i papritur i Ministrisë së Ekonomisë, më 9 tetor të viti 2014, lidhur me prolongimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike. Me këtë Maqedonia e shkeli Marrëveshjen për themelimin e komunitetit energjetik, siç deklaroi edhe Drejtori i Sekretariatit të Komunitetit Energjetik.<sup>60</sup> Justifikimi për këtë prolongim është se çmimi i energjisë elektrike për ekonomitë familjare do të rritet.<sup>61</sup> Rritja e çmimit të energjisë elektrike, siç u tha më lart, është diçka që shqetëson gjithnjë e më shumë, por pyetja e vërtetë, e cila duhet të shtrohet, është se deri në cilën shkallë politikat energjetike, të miratuara në letër, implementohen me qëllim që të reduktohen efektet nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike? Veçanërisht procesi i gazifikimit dhe reforma e tregut të energjisë termike? Siç tregon analiza e pasqyruar më lart, këto politika duhet të zbatohen në të ardhmen. Të gjitha politikat për reformën e sektorit energjetik shkojnë në

drejtim të përmirësimit të standardit jetësor të qytetarëve, si dhe kontribuojnë në drejtim të rritjes së sigurisë gjatë furnizimit.

#### **4. Rezistenca – aftësia për t’iu përgjigjur ndërprerjeve të importit të energjisë përmes zëvendësimit me furnizues dhe ruta të tjera të furnizimit dhe aftësi për t’iu përgjigjur ndërprerjeve gjatë furnizimit me energji**

##### *4.1 Magazinimi i energjisë*

Angazhimet e Maqedonisë në drejtim të integritimit në familjen e BE-së zhvillohen në përputhje me rritjen ndër vite të rezervave të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës – rezervat e naftës kanë qenë të barabarta me vetëm 26 ditë konsum mesatar në vitin 2010, dhe janë rritur në 57 ditë konsum mesatar në vitin 2014.<sup>62</sup> Ligji për rezervat e detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës përcakton se sasitë e përgjithshme të rezervave të derivatit përkatës të naftës duhet të arrijnë pëmbushje të konsumit të realizuar mesatar ditor të atij derivati të naftës për periudhë prej 90 ditësh në vitin paraprak kalendarik ose 25% nga konsumi i realizuar në total të derivatit përkatës të naftës në vitin paraprak kalendarik.<sup>63</sup> Edhe pse objektivi i parashikuar nuk është arritur akoma, rritja e rezervave të naftës është shenjë e zhvillimit pozitiv.

##### *4.2 Aftësia e shfrytëzimit të burimeve të tjera të energjisë në rast të ndërprerjes*

Ndërprerja e mundshme e livrimit me gaz është në korrelacion të drejtpërdrejtë me mundësinë e vendit i cili është i interesuar t’i përgjigjet sfidës, nëse përmes shfrytëzimit të rezervave, pranimit të ndihmës nga ana e fqinjëve ose aftësia për shfrytëzimin dhe ridedikimin në lloje të tjera të energjisë. Vendet e rajonit tonë më të largët, siç është Italia, Polonia dhe Sllovakia e kanë

<sup>59</sup> Sonja Zuber, Ana Stojilovska, "Analiza e Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për energjetikë nga muaji maj 2013", Analitika, 2013, vizita e fundit 25 tetor 2014 [http://www.analyticamk.org/images/stories/files/briefs/13049-Policy\\_Brief\\_zakonot\\_za\\_energetika\\_2013.pdf](http://www.analyticamk.org/images/stories/files/briefs/13049-Policy_Brief_zakonot_za_energetika_2013.pdf)

<sup>60</sup> Sonja Zuber, "Të humbur në reforma? Çka pason pas planifikimit të keq të prolongimit të liberalizimit të tregut të energjisë në Maqedoni?", vizituar më 23 tetor 2014 [http://analyticamk.org/images/stories/files/2014/izgubeni\\_reformite.pdf](http://analyticamk.org/images/stories/files/2014/izgubeni_reformite.pdf)

<sup>61</sup> Faktor, Zyrtare: Faza e fundit e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike poongohet deri në vitin 2020!" 9 tetor 2014, vizituar më 25 tetor 2014 <http://faktor.mk/archives/126273#>

<sup>62</sup> Komisioni Evropian, Maqedonia 2010 Raport Progresi me Komunikimin nga Komisioni deri te Parlamenti Evropian dhe Këshilli Strategjia për zgjerim dhe sfidat kryesore 2010-2011, (2010), vizituar më 23 tetor 2014 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/pack\\_age/](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/pack_age/)

<sup>63</sup> Komisioni Evropian, Maqedonia Raport Progresi, (2014), vizituar më 23 tetor 2014 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf)

<sup>63</sup> "Ligji për rezerva të detyrueshme të naftës dhe derivateve të naftës", "Gazeta Zyrtare 84/08, vizituar më 23 tetor 2014



mundësinë e shfrytëzimit të rezervave të tyre të gazit në kohëzgjatje prej tre muajsh nëse ndodhë ndërprerja e këtij burimi energjetik nga Rusia-Ukraina. Serbia mund të mbështetet mbi rezervat e gazit të Hungarisë, ndërsa Sllovenia dhe Kroacia kanë mundësi t'i shfrytëzojnë rezervat e Italisë, Austrisë dhe Hungarisë.<sup>64</sup>

Nga ana tjetër, Maqedonia nuk ka kapacitete të veçanta për magazinimin e gazit. Ka vetëm rezerva të kufizuara të stacionuara në vet tubacionin e gazit të cilat mund të zgjasin rreth një javë.<sup>65</sup> Si shfrytëzues relativisht i vogël i gazit natyror i cili livrimin e plotë prej rreth 130 milionë metra kub i pranon përmes burimit<sup>66</sup> të vetëm dhe kalon nëpër rajone jostabile, siç është për shembull Ukraina, e cila në mënyrë plotësuese e rrit rrezikun. Nga ana tjetër, fakti që hyrja e vetme e gazit rus në Maqedoni është përmes Bullgarisë fqinje furnizimin me gaz të Maqedonisë e bën të lidhur ngushtë edhe me zhvillimin e ngjarjeve në Bullgari. Nëse ndodhë reduktimi ose ndërprerja e livrimit të gazit rus, do të varet nga autoritetet në Bullgari a do të vazhdojnë me livrimin e edhe ashtu sasive të reduktuara në drejtim të Maqedonisë? Bullgaria ka kapacitete të kufizuara për magazinimin e rezervave të gazit duke i shfrytëzuar vendburimet e vjetra të gazit.<sup>67</sup>

Gjatë kohës së krizës së gazit në vitin 2009, si dhe në kohën kur Makpetroll (furnizues me gaz), e ndërpreu livrimin me gaz në vitin 2011, vetëm një fabrikë Makstill kishte probleme meqë nuk kishte mundësi ta vazhdojë punën e vet duke shfrytëzuar burime të tjera të energjisë.<sup>68</sup> Megjithatë, në rast të mungesës së energjisë elektrike, një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve të energjisë do të goditen. Sektor më fragjil do të jetë ai i ekonomive familjare, meqë ato në masë të madhe mbështeten mbi energjinë elektrike. Sido që të jetë, mungesa e energjisë elektrike nuk do të ndikojë vetëm

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/9C8BE756C108374B9E7384DDC63C2B4F.pdf>

<sup>64</sup> "Maqedonia, Bullgaria dhe Rumania më fragjile ndaj gazit rus." Utrinski vesnik, 18 mars, 2014. Vizituar më 26 korrik, 2014.

<sup>65</sup> "Ekspertët demantojnë: Nëse ka krizë gazi, Maqedonia nuk rrezikohet!" Veçer, 17 tetor, 2014. Vizituar më 18 tetor, 2014. <http://vecer.mk/ekonomija/ekspertite-demantiraat-ako-imagasna-kriza-makedonija-ne-e-zagrozena>.

<sup>66</sup> Pavkovikj, Zdenka. "Maqedonia do të përballet me dëmtime te vogla, Evropa me të mëdha [Macedonia Will Face Little Damage, Europe Huge]". Dnevnik, 5 Mars, 2014. Arrihet me 11 Gusht 2014. <http://dnevnik.mk/?ItemID=C169252B6144DE46B4BE255D4BAB719E>

<sup>67</sup> ibid.

<sup>68</sup> "Ekspertët demantojnë: Nëse ka krizë gazi, Maqedonia nuk rrezikohet!" Veçer, 17 tetor, 2014. Vizituar më 18 tetor 2014. <http://vecer.mk/ekonomija/ekspertite-demantiraat-ako-imagasna-kriza-makedonija-ne-e-zagrozena>.

mbi ekonominë familjare por edhe mbi vet industrinë (shih: Tabelën 2 dhe 3).

#### 4.3 Diversifikimi energjetik dhe lidhja me gazsjellës

Siç e konfirmon edhe Strategjia Energjetike, Maqedonia i ka parasysh disa burime të mundshme për furnizimin me gaz natyror të Maqedonisë, siç është "Rrjedha Jugore" e cila livron gazin rus dhe kaspik, "Rrjedha e Kaltër", e cila livron gazin rus përmes Bullgarisë, "Rrjedha e Bardhë", e cila livron gaz kaspik përmes Rumanisë, "Nabuko" hidro-gaz natyror, i cili transportohet përmes Greqisë, Shqipërisë, Malit të Zi ose Kroacisë dhe ngjashëm. Një nga prioritetet e Strategjisë Energjetike është rritja e shfrytëzimit të gazit natyror.<sup>69</sup> Duke e pasur parasysh faktin se lidhja në gazsjellës ndërkombëtar përfshin shumë faktorë, ndërsa punët shpeshherë mund të jenë të paparashikueshme, një opsion tjetër afatmesëm për Maqedoninë është të vazhdojë t'i përmbush nevojat e veta me gaz përmes shfrytëzimit të kapaciteteve të plota të gazsjellësit ekzistues, i cili me kapacitetin e tanishëm mund ta furnizojë Maqedoninë për më së paku edhe për 5 vjet. Një opsion tjetër, të cilin ndërkohë mund ta ndërmer shteti është ta rris kapacitetin e gazsjellësit të vet ekzistues me një impiant kompresimi prej 800 milionë m<sup>3</sup> në 1.2 miliardë m<sup>3</sup> në nivel vjetor, që mjafton për furnizimin e vendit për 15 deri në 20 vitet e ardhshëm.<sup>70</sup> Shfrytëzimi i kapacitetit të sistemit për transmetimin e gazit natyror mbetet i vogël dhe është 20% në vitin 2013. Kjo është një shenjë pozitive meqë përqindja, në vitin 2012 ishte 17%, ndërsa në vitin 2011 ishte 16.9%.<sup>71</sup> Lidhja në gazsjellës rajonal duhet të

<sup>69</sup> Ministria e Ekonomisë të Republikës së Maqedonisë, "Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030", (2010), vizituar më 23 tetor 2014 [http://www.ea.gov.mk/images/stories/E\\_Izdanija/Energetika\\_Strategjia\\_za\\_energetika\\_na\\_RM\\_do\\_2030\\_SV\\_61\\_2010\\_244131078.pdf](http://www.ea.gov.mk/images/stories/E_Izdanija/Energetika_Strategjia_za_energetika_na_RM_do_2030_SV_61_2010_244131078.pdf)

<sup>70</sup> Analitika dhe partner, Forum: Strategjia energjetike, siguria dhe gazifikimi në Maqedoni dhe rajon më 11 qershor 2013, Konkluzione nga konferenca, vizituar më 25 tetor 2014 <http://analyticamk.org/images/stories/files/2014/Conclusions.pdf>

<sup>71</sup> Komisioni Rregullator për Energjetikë, Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2011", (2012), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatorena%20komisija%20za%20energetika%20za%202011%20godina.pdf> ; Komisioni Rregullator për Energjetikë, Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2012" (2013), vizituar më 23 tetor 2014

<http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatorena%20komisija%20za%20energetika%20za%202012%20godina.pdf> ; Komisioni Rregullator për Energjetikë, Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatorena%20komisija%20za%20energetika%20za%202013%20godina.pdf>





zhvillohet paralelisht me procesin e ndërtimit të rrjetit shpërndarës të gazit meqë rrjeti shpërndarës është vendimtar që gazi natyror të arrijë deri te ekonomitë familjare. Siç njofton Komisioni Rregullator për Energjetikë në raportin e tij vjetor për vitin 2013, ka ekonomi familjare të cilat janë të lidhura në rrjetin shpërndarës të gazsjellësit, që nuk ishte rast në vitin 2012.<sup>72</sup> Edhe pse nuk kemi të dhëna konkrete për numrin e ekonomive familjare të lidhura në këtë rrjet, megjithatë numri i tyre është i vogël për shkak të faktit se vetëm dy komuna – Kumanova dhe Strumica dhe zona zhvillimore teknologjike industriale Bunarxhik i zgjerojnë rrjetet e tyre shpërndarëse. Kjo është një shenjë e zhvillimit pozitiv dhe është një indikator se projektet lokale të gazifikimit duhet të vazhdojnë.

#### 4.4 Rritja e prodhimit vendas

Njëri nga prioritetet e Strategjisë Energjetike është rritja e pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme. Strategjia Energjetike, nga ana tjetër, pohon se për sigurinë energjetike nevojitet shfrytëzimi maksimal i resurseve vendase. Strategjia ka vlerësuar se Maqedonia ka potencial të konsiderueshëm për burime të rinovueshme të energjisë dhe për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe për prodhimin e energjisë termike. Më konkretisht, potenciali i pashfrytëzuar i burimeve të rinovueshme, i cili mund të shfrytëzohet deri në vitin 2013 është 3795 GWh në nivel vjetor për prodhimin e energjisë elektrike dhe 1565 GWh në nivel vjetor për prodhimin e energjisë termike.<sup>73</sup> Qeveria, nga ana tjetër, miratoi vendim për objektivat dhe dinamikën vjetore të rritjes së pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë në konsumin final të energjisë, sipas të cilit pjesëmarrja e burimeve të rinovueshme deri në fund të vitit 2013, në konsumin final të energjisë duhet të jetë

17.6% ndërsa deri në vitin 2020 të jetë 21%.<sup>74</sup> Megjithatë, nëse e konsultojmë statistikën mund të konkludojmë se pjesëmarrja e parashikuar për vitin 2013 nuk është arritur. Në të vërtetë, pjesëmarrja e burimeve të rinovueshme në bruto konsumin final të energjisë në vitin 2013 (të dhëna paraprake) ishte 15.3% (përlllogaritur me vlera të mirëfillta) dhe 15.6% (përlllogaritur me vlera të normalizuara).<sup>75</sup>

---

ota%20na%20Regulatore%20komisija%20za%20energetika%20na%20RM%20za%202013%20godina.pdf

<sup>72</sup> Komisioni Rregullator për Energjetikë, Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatore%20komisija%20za%20energetika%20na%20RM%20za%202013%20godina.pdf> ; Komisioni Rregullator për Energjetikë, Raport vjetor për punën e Komisionit Rregullator për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë në vitin 2012", (2013), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.erc.org.mk/odluki/Godisen%20izvestaj%20za%20rabota%20na%20Regulatore%20komisija%20za%20energetika%20na%20RM%20za%202012%20godina.pdf>

<sup>73</sup> Ministria e Ekonomisë e Republikës së Maqedonisë, "Strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2030", (2010), vizituar më 23 tetor 2014 [http://www.ea.gov.mk/images/stories/E\\_Izdanija/Energetika\\_Strategjia\\_za\\_energetika\\_na\\_RM\\_do\\_2030\\_\\_SV\\_61\\_2010\\_\\_244131078.pdf](http://www.ea.gov.mk/images/stories/E_Izdanija/Energetika_Strategjia_za_energetika_na_RM_do_2030__SV_61_2010__244131078.pdf)

---

<sup>74</sup> "Vendim për objektivat dhe dinamikën vjetore të rritjes së pjesëmarrjes së energjisë nga burime të rinovueshme të energjisë në konsumin final të energjisë", "Gazeta Zyrtare" 100/11, vizita e fundit më 23 tetor 2014

<http://www.slvesnik.com.mk/Issues/47D56301AAB3324281A085DAAC0AEF98.pdf>

<sup>75</sup> Enti Shtetëror i Statistikës, "Balance energjetike 2013", (2014), vizituar më 23 tetor 2014 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2014/6.1.14.79.pdf>



## Vërejtje Përfundimtare

Ngjarjet në Ukrainë do të vazhdojnë t'i mbushin faqet e para të shtypit në Evropë ashtu siç përkeqësohet situata nga dita në ditë. Sektori i saj energjetik do të vazhdojë të përballet me vështirësi e që do të çojë deri në nivel të rritur të aktivitetit diplomatik midis Brukselit, Kievit dhe Moskës, me qëllim që të sigurohet livrimi me gaz si për BE ashtu edhe për Ukrainën. Me afrimin e dimrit, korrespondenca dhe akuzat midis Kievit dhe Moskës do të vazhdojnë të rriten me potencial që të shndërrohen edhe në një krizë gazi. Maqedonia duhet ta ndjek me vëmendje këtë zhvillim të ngjarjeve që të mund të reagojë me kohë ndaj një ndërprerjeje të mundshme të livrimit të gazit natyror.

Lidhja në "Rrjedhën Jugore" do të sigurojë qarkullim dukshëm më të madh të gazit në Maqedoni, megjithatë politizimi i saj këtë proces e bën fragjil ndaj presioneve politike. Maqedonia, në këtë aspekt, si vend kandidat për anëtarësim në BE duhet ta respektoj rekomandimin e BE dhe ta harmonizojë Marrëveshjen për lidhje në "Rrjedhën Jugore" me të drejtën evropiane në fushën e energjetikës. Për shkak të pasigurisë rreth implementimit të saj, autoritetet maqedonase duhet të ndërmarrin hapa serioz për lidhje në Gazsjellësin Trans-Adriatik.

Për fatin tonë, Maqedonia sot gjendet në një mjedis më stabil dhe në një mjedis të parashikueshëm politik, në të cilin bashkëpunimi rajonal është vendimtar për integrimin e mëtutjeshëm në Bashkimin Evropian. Bashkëpunimi në fushën e energjetikës është i domosdoshëm edhe atë jo vetëm atëherë kur bëhet fjalë për projekte të përbashkëta energjetike por edhe në rast të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të shkaktuara nga faktori njeri. Nga vërshimet në Serbi mund të nxjerrim mësim sa i përket fragjilitetit infrastrukturor si dhe efekteve negative të cilat mund t'i shkaktojnë ndryshimet klimatike mbi sektorin energjetik.

Përderisa BE është e shqetësuar për mungesën e gazit natyror, Maqedonia është më fragjile ndaj energjisë elektrike. Kjo mund të konkludohet nga bilancet energjetike në Maqedoni, pjesëmarrja e energjisë elektrike të cilën e shfrytëzojnë ekonomitë familjare por edhe industria, si dhe fakti se rritet importi i energjisë elektrike. Gjithashtu, duke e pasur parasysh krizën elektro-energjetike në vitin 2012, duhet të bëhen përpjekje për reduktimin e kësaj situate të fragjilitetit nga energjia elektrike. Kjo mund të arrihet përmes shfrytëzimit të burimeve tjera të energjisë termike për ekonomitë familjare përveç energjisë elektrike (gazi natyror, ngrohja qendrore e zhvilluar, shfrytëzimi efikas i drurit të zjarrit, masat e efikasitetit energjetik, etj.), fokusimi mbi shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme dhe gazit natyror.

Ashtu siç do të rriten çmimet e energjisë elektrike në periudhën e ardhshme, Maqedonia në mënyrë intensive duhet të vazhdojë me reformat energjetike për reduktimin e pasojave nga çmimet në rritje të burimeve energjetike si reforma për përmirësimin e tregut të energjisë termike, përmirësimin e efikasitetit energjetik, mbështetjen e projekteve lokale për gazifikim dhe vazhdimin e planeve për gazifikimin në nivel qendror.

Edhe pse aktualisht nuk është çështja më e rëndësishme sa i përket sigurisë energjetike, rritja e shfrytëzimit të gazit natyror nënkupton se vendi duhet të mendojë në mënyrë më intensive për gazin natyror, nga aspekti i sigurisë energjetike, të përpiqet të lidhet në sa është e mundur më shumë gazsjellës, por më e rëndësishme është të ndërmerren të gjitha masat të cilat në ndërkohë mund t'i realizojë vet – ta shfrytëzojë kapacitetin maksimal të gazsjellësit të vet, si dhe ta rris kapacitetin e tij.

Meqë paraqet shkelje të Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit Energjetik, Qeveria duhet ta rishqyrtojë vendimin për prolongimin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike.

E fundit, por jo edhe më pak e rëndësishme, është vet përkufizimi i sigurisë energjetike e cila nënkupton rritje të numrit të burimeve energjetike dhe numrit të furnizuesve me energji. Prandaj, Maqedonia duhet të vazhdojë me angazhimet e veta për diversifikimin e burimeve energjetike në miksin energjetik dhe ta rris numrin e furnizuesve.

# EU POLICY

## PËR AUTORËT

**Andreja Bogdanovski** punon si hulumtues për çështje sigurie dhe politikë të jashtme në Analitika nga viti 2009. Është autor i disa studimeve në lidhje me sundimin demokratik dhe reformat në sektorin e sigurisë në Maqedoni. Z. Bogdanovski është Magjistër për Paqe dhe Sigurisë Ndërkombëtare në Katedrën për Studime Ushtarake nga King Koleh London. Në fokusin e interesimit të tij janë: siguria ndërkombëtare, gjeopolitika, rreziku politik, shtetet de-fakto, reformat në sektorin e sigurisë, menaxhimi me shërbimet e zbulimit, etj. Kontakti i tij: [abogdanovski@analyticamk.org](mailto:abogdanovski@analyticamk.org) or [bogdanovski.a@gmail.com](mailto:bogdanovski.a@gmail.com)

**Ana Stojilovska** është hulumtuuese e Programit për Energjetikë dhe Infrastrukturë në Analitika Think Tank, Shkup nga viti 2010. Ka magjistruar për studime evropiane në Kolehin European Hamburg – Universiteti Hamburg. Stojilovska është autore e disa punimeve në temën energjetikë. Në fokusin e hulumtimit të saj është: politika energjetike, efikasiteti energjetik, burimet e rinovueshme të energjisë, tregu i energjisë termike, gazifikimi, siguria energjetike, kogjenerimi, varfëria energjetike, rrjetet trans-evropiane, zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, e drejta e përgjithshme e BE-së – Kapitulli 15, 21, bashkëpunimi midis Qeverisë dhe shoqërisë civile – të gjitha relevante për Maqedoninë. Kontakti i saj: [astojilovska@analyticamk.org](mailto:astojilovska@analyticamk.org) dhe [preveduvacka@yahoo.com](mailto:preveduvacka@yahoo.com)

**Qëndrimet e prezantuara në këtë analizë janë pikëpamje personale të autorëve të tekstit dhe nuk i pasqyrojnë qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.**

## Kontakte:



**Fondacionit Konrad Adenauer**  
Maksim Gorki 16 / kati 3  
MK – 1000 Shkup  
Telefon +389 (2) 3231 122  
Telefaks +389 (2) 3135 290  
[Skopje@kas.de](mailto:Skopje@kas.de)  
[www.kas.de/macedonia](http://www.kas.de/macedonia)



**Analitika Think Tank**  
Dame Gruev 7-8/3  
MK-1000 Shkup  
Telefon +389 (2) 312 1948  
Telefaks +389 (2) 312 1948  
[info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)  
<http://analyticamk.org/>